

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E Kryeministrit - UREDI Premejhera - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Nesia Org. Org. Locence Org. Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.:
011. c	3958
Nr. i faqeve Bi stranica No. pages:	Data: Datumi: Date:
90	14/12/2018
Prishtine / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Koordinatori Nacional për Kulturë Rini dhe Sport
Nacionalni Koordinator za Kulturu, Omladinu i Sport
National Coordinator for Culture, Youth and Sport

RAPORT

Implementimi i Thirrjes Publike për Ofrimin e Mbështetjes Financiare Publike për Financimin e OJQ-ve me qëllim të forcimit dhe promovimit të dijes, sportit dhe kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik, në këtë përbërje:

1. Hyrje

Zyra e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport ka bërë Thirrje publike për mbështetje financiare publike për organizatat jo-qeveritare me qëllim të forcimit dhe promovimit të dijes, sportit dhe kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik dt. 09.11.2018 duke u bazuar në kriteret e parapara në Rregulloren MF, Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve. Në Këtë Thirrje Publike kanë aplikuar gjithsej 50 OJQ me gjithsej 50 projekte.

2. Qëllimi i Thirrjes Publike

Zyra e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport përmes vendimit Nr.067/2018 të dt. 09.11.2018 ka bërë shpalljen e Thirrjes Publike për mbështetje financiare publike për OJQ-të që implementojnë projekte nga fusha e Kulturës, Dijes dhe Kreativitetit Kulturor. Vlera totale e planifikuar e thirrjes publike ishte 140,000 EUR.

3. Informata mbi OJQ-të aplikuese dhe përfituesit

Në kuadër të kësaj thirrje publike kanë aplikuar gjithsej 50 OJQ me gjithsej 50 projekte.

Në vijim është paraqitur lista e të gjithë aplikantëve (OJQ-ve) që kanë aplikuar në kuadër të thirrjes publike:

- 001 Forumi për shoqëri Civile – Mitrovicë
- 002 Shoqata Edukative Rinia – Pejë
- 003 Prishtina REA
- 004 Udruzanje za Kulturu Plejada005 Organizata Rinore DEA
- 006 Progresi Rinor – Shtërpçë
- 007 Shoqata për Barazi Gjinore dhe të Drejta të Komuniteteve – Demokracia
- 008 Valët e Paqes
- 009 Global Mission
- 010 Kosova in EU
- 011 Qendra për Avancimin e Shoqërisë – QASH
- 012 IPKO Fondation
- 013 Qendra Kreative Cërmjan – Gjakovë
- 014 Bashkimi Rinor e Ardhmja e Ndritur – BRAN
- 015 OJQ ETRI
- 016 Instituti IMD
- 017 Qendra Kosovare për Arsim dhe Kulturë – QKAK
- 018 OJQ IPKY
- 019 Organizata për Zhvillim – Llogaritari
- 020 Trupa Teatrale Profesionale – Pejë
- 021 Partners in Action – PACT
- 022 OJQ ZEBRA
- 023 OJQ ROYAL
- 024 Zogjët e Paqes
- 025 Qendra e Rinisë Lipjan – LYC
- 026 Vullneti Rinor
- 027 Vullnetarizmi në Kosovë
- 028 Advocacy for Society Development – AFSD
- 029 Federatat e Parkurit të Kosovës – FPK
- 030 KMDLNK
- 031 Qendra Rinore – Obiliq
- 032 Mundësia
- 033 Research – RCH
- 034 General Youth Education of Kosovo – GYEK

- 035 ETIKA
- 036 Organizata Veprimi për Ligjin dhe Demokracinë - VLD
- 037 Qendra për Zhvillim Ekonomik dhe Social - CESD
- 038 Shoqata e Gruas "Jeta" - Deçan
- 039 Cult Culb
- 040 Iniciativa e Femrës Kosovare - IFK
- 041 Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural të Kosovës - RrOZhRK
- 042 Akademia për të Drejtat e Fëmijës
- 043 Qendra për Politika Hulumtuese
- 044 Youth Ecological and Security Zone - ECOZ
- 045 Innovative Community Development Center - ICDC
- 046 Center for Education and Development Elita
- 047 Today Toëards Future - TF
- 048 Organisation of Strategic Development - OSD
- 049 Youth Symbol of Change - YSCH
- 050 Dardana Press - Kamenicë

4. Vlerësimi dhe publikimi i rezultateve

Zyra e Koordinatorit Nacional me Vendimin Nr. 083-18 të dt. 03.11.2018 ka themeluar Komisionin vlerësues për përzgjedhjen e Projekteve për Mbështetje Financiare për OJQ-të të cilat kane aplikuar për mbështetje financiare.

Komisioni përbëhet nga dy zyrtar nga Kryeministria një nga Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sportit 2 përfaqësues në cilësinë e ekspertëve të jashtëm, ku njëri prej tyre nga shoqëria civile.

Komisioni vlerësues i themeluar në përputhje me Rregulloren MF. Nr.04/2017, ka shqyrtuar të gjitha aplikacionet nga aspekti procedural dhe nga aspekti përmbajtësor i projektpropozimeve. Gjatë shqyrtimit të aplikacioneve nga aspekti procedural, komisioni vlerësues ka vendosur që të refuzojë 12 aplikacione të OJQ-ve për shkak se nuk i kanë plotësuar kriteret e aspektit procedural.

Komisioni vlerësues bazuar në Rregulloren e Punës së Komisionit dhe Planin e realizimit të Vlerësimit të Projekt Propozimeve, Procesin i vlerësimit të aplikacioneve për Thirrjen Publike të datës 09.11.2018 e ka filluar me datën 03.12.2018 dhe puna e tij ka përfunduar më datën 05.12.2018.

Takimet e radhës të Komisionit janë mbajtur me datat si në vijim: nga data 06.12.2018 deri më 07.12.2018. Komisioni pas shqyrtimit administrativ dhe vlerësimit përmbajtësor të projekteve Komisioni Vlerësues ka përgatitur listën paraprake të vlerësimit. Kjo listë ka në përmbajtjen e saj

edhe vlerësimin në baze të pikëve dhe renditjen për OJQ-të të cilat janë përzgjedhur për të marrë mbështetje nga thirrja e Zyrës së Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport.

Nr.	Subjekti	Mesatarja e Pikeve
006	Progresi Rinor - Shtërpçë	72.2
028	Advocacy for Society Development - AFSD	70.6
005	Organizata Rinore – DEA	70.4
022	OJQ ZEBRA	69.4
017	Qendra Kosovare për Arsim dhe Kulturë - QKAK	69.2
019	Organizata për Zhvillim Llogaritari	69
012	Ipko Fondation	68.4
040	Iniciativa e Femrës Kosovare (IFK)	68
020	Trupa Teatrale Profesionale - Pejë	67.8
030	KMDLNJ	67.4
003	Prishtina REA	67
047	Today Towards Future TF	66.2
023	OJQ ROYAL	66
036	Organisation of strategic development (OSD)	65.2
048	Organizata Veprimi për Ligjin dhe Demokracinë - VLD	65.2
024	Zogjët e Paqes	65
039	Cult Club	60.6
032	Mundësia	59.8

Me datë 07.12.2018 Komisioni i Vlerësimit i është drejtuar secilës organizatë aplikuese e cila gjendet në listën paraprake që të harmonizojnë buxhetin konform rekomandimeve dhe aprovimeve të shumës së buxhetit nga ana e Komisioni të Vlerësimit.

Në fazën e ankesave gjithsej janë pranuar 6 ankesa nga OJQ-të për të cilat komisioni për shqyrtimin e ankesave i themeluar nga Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport ka vendosur t'i refuzojë. Si dhe një ankesë është dorëzuar jashtë afatit kohor të ankesave, të cilën komisioni ka vendosur mos ta shqyrtojë.

Takimi i radhës së komisionit është mbajtur me datë 14.12.2018, dhe ky ka qenë takim përmbyllës i Komisionit lidhur me këtë thirrje. Në këtë takim janë kontrolluar dokumentet e dorëzuar nga OJQ-ët dhe është verifikuar harmonizimi i shumave në tabelën e buxhetit sipas shumës së aprovuar nga Komisioni.

Sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren në fjalë, pas publikimit të Vendimit përfundimtar dhe përfundimit të afatit të ankesave i është hapur rrugë përgatitjes së kontratave

me OJQ-të përfituese, të cilat janë përzgjedhur për të marrë mbështetje nga Zyra e Koordinatorit Nacional për Kulture, Rini dhe Sport.

Komisioni Vlerësues i projekt propozimeve të dorëzuara nga OJQ-të aplikuese:

1. Feim Hoxha - Kryetar i Komisionit



2. Qerim Berisha- Anëtar i Komisionit



3. Armenda Shala - Anëtare e Komisionit



4. Faton Morina - Anëtar i Komisionit



5. Arbnora Shehu-Bunjaku - Anëtare e Komisionit

